



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*MINISTRIA E FINANCAVE/MINISTARSTVO ZA FINANSIJE*  
*MINISTRY OF FINANCE*

KB FR Kosovo Board on Standards for Financial Reporting  
 BK RF Bordi Kosovar mbi Standardet per Raportim Financiar  
 KB FI Kosovski Bord za Standarde Finansijskog Izvestavanja

**SKK 2**  
**Stoqet**

**Qëllimi**

Qëllimi i këtij standardi është që të përshkruaj trajtimin e stoqeve në kontabilitet sipas sistemit të kostos historike. Stoqet janë zëra të blerë apo të përpunuar (prodhuar) nga ndërmarrja për t'u shitur gjatë rrjedhës së rëndomtë të afarizmit. Si çështje primare në kontabilitet sa i përket stoqeve është se sa do të jetë shumta e kostos e cila do të pranohet si pasuri dhe e cila nuk do të raportohet përderisa të pranohen të hyrat e ndërlidhura me këtë pasuri.

**Fushëveprimi**

1. Ky standard duhet të aplikohet në pasqyra financiare të përgatitura sipas parimit të kostos historike të kontabilitetit në lidhje me stoqet, përveç në rastet kur kemi të bëjmë me:
  - a. Puna në vijim që bëhet me kontrata ndërtimore;
  - b. Instrumente financiare; dhe
  - c. Stoqe të produkteve bujqësore, të pylltarisë dhe të gjësë së gjallë.

## Përkufizimet

2. Termet vijuese të përdorura në këtë standard janë me këto kuptime specifike:
  - a. **Stoqet** janë pasuri:
    - i. Të cilat mbahen për t'u shitur gjatë rrjedhës së rëndomtë të afarizmit;
    - ii. Që janë në procesin e prodhimit për atë shitje; apo
    - iii. Që janë në formë të materialeve apo furnizimeve të cilat do të konsumohen gjatë procesit të prodhimit apo gjatë kryerjes së shërbimeve.
  - b. **Vlera e arkëtueshme neto** është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë veprimtarisë së rëndomtë të biznesit, e zvogëluar për kostot e vlerësuara të kompletimit dhe kostove të vlerësuara të domosdoshme që shitja të kryhet.

## Matja dhe kostoja e stoqeve

3. Stoqet duhet të maten sipas koston apo sipas vlerës së realizueshme neto varësisht se cila prej tyre është më e ulët. Stoqet zakonisht zvogëlohen në shumën e realizueshme neto sipas zërave veç e veç apo në grupe të zërave të ngjashëm apo të zërave përkatës, kur është e përshtatshme.
4. Kostoja e stoqeve duhet të përmbajë të gjitha kostot e blerjes, koston e konvertimit si dhe kostot tjera të krijuara për t'i sjellur stoqet në vendndodhjen dhe kushtet ekzistuese.

*Kostoja e stoqeve (d.m.th. vlera e punës në vijim) tek ofruesit e shërbimeve (p.sh. ofruesit të shërbimeve të kontabilitetit) përbëhet kryesisht nga fuqia e punës si dhe kostoja tjetër e personelit e cila është në mënyrë të drejtpërdrejtë e ndërlidhur me ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë edhe një pjesë të punës mbikqyrëse dhe shpenzimeve të përgjithshme përkatëse.*

5. Kostoja e stoqeve do të duhej të përcaktohej duke përdorur ose i-pari-brenda, i-pari-jashtë (FIFO) ose formulat e koston mesatare të ponderuar përveç kur kostot e mallrave apo shërbimeve specifike do të mund të përcaktoheshin sipas kostove të tyre individuale të cilat janë specifike. Një shembull i përdorimit të formulës mesatare të ponderuar është dhënë në fund të këtij standardi.

6. Një ndërmarrje duhet të shfrytëzoj formulë të njëjtë për llogaritjen e kostos për të gjitha stoqet e natyrës së njëjtë dhe për stoqet që shfrytëzohen për qëllime të njëjta nga ndërmarrja (parimi i konsekuencës).

### **Njohja si një shpenzim**

7. Pasi stoqet të jenë shitur, shuma e regjistruar e atyre stoqeve duhet të njihet si një shpenzim për periudhën në të cilën janë pranuar si të hyra. Çfarëdo ndryshimi i shlyerjes së stoqeve për në vlerën e arkëtueshme neto dhe për të gjitha humbjet e tjera duhet të njihet si një shpenzim për periudhën kur shlyerja apo humbja ndodh.

### **Shpalosja**

8. Pasqyrat financiare duhet të shpalosin:
  - a. Politikat e kontabile të cilat janë zbatuar në matjen e stoqeve, duke përfshirë edhe formulën e cila është përdorur për llogaritjen e kostos.
  - b. Kostoja e stoqeve e njohur si shpenzim gjatë periudhës;
  - c. Shumën e tërësishme të regjistruar të stoqeve të raportuara, të analizuar në klasifikime të përshtatshme për ndërmarrjen;
  - d. Shumën e tërësishme të regjistruar të stoqeve të raportuara sipas vlerës neto të arkëtueshme; dhe
  - e. Shumën e ndarë të stoqeve të zotuar si siguri ndaj detyrimeve.

### **Data e hyrjes në fuqi**

9. Ky standard do të jetë i plotëfuqishëm për pasqyrat financiare të cilat mbulojnë periudhat të cilat fillojnë me 1 Janar 2002 apo pas tij. Aplikimi i mëhershëm i këtij standardi, është i rekomanduar.

## SHEMBULL – FORMULA E KOSTOS MESTARE TË PONDERUAR

Sipas metodës së kostos mesatare të ponderuar, kostoja mesatare për një njësi llogaritet duke ndarë koston e tërësishme të mallrave në dispozicion për shitje me numrin e tërësishëm të njësive në dispozicion për shitje.

	Nr. i njësive	Kostoja e njësive DM	Kosto totale DM
Stoqet në fillim	10	10	100.00
Blerja 1	12	11	132.00
Blerja 2	15	12	180.00
Mallrat në dispozicion për shitje	37		412.00
Kostoja mesatare e ponderuar për një njësi	$412/37 = 11.14 \text{ DM}$		
Shitja gjate periudhës	18 njësi		
Atëherë kostoja e produkteve të shitura është	$11.14 \times 18 = 200.52$		
Stoqet në fund	$11.14 \times 19 = 211.66$		